



|  |           |          |                   |
|--|-----------|----------|-------------------|
| Pranuar / Dërguar / Prilazur / Prilazur / Received / Delivered | 16.02     | 1        | viti / god / year |
| Organi / Njësia / Organ / Jedinka / Org / Unit                 | SKPM/SHCK | 680/2021 | 114               |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.437/2020

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.437/2020, të datës 28.12.2020, e parashtruar nga \_\_\_\_\_ me adresë banimi Rr “Vëllezërit Gërvalla”, Nr. 23, Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.02.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.Obligohet** Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës që të bëjë rishqyrtimin e ankesës të datës 10.11.2020, të paraqitur nga parashtruesi i ankesës \_\_\_\_\_ duke shqyrtuar hollësisht të gjitha pretendimet të cilat ndërlidhen me këtë ankesë, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**II.Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës** ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi

**III.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**IV.Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e kryetarit të kolegjit.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, sipas akt emërimit të datës 03.07.2019, në pozitën “Zyrtar për Distribuimin e Dokumenteve I, me Vendimin me Nr.Prot.DPSKPK/Nr.56/2020 të datës 14.02.2020 është pezulluar nga puna me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë me Aktvendimin PP/I.nr.21/20 të datës 07.09.2020 ka pushuar hetimet ndaj ankuesit. Ankuesi më datë 11.09.2020 ka parashtruar kërkesë për kthim në vendin e punës dhe kompensim të pagave të papaguara.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 29.10.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot: DPSKPK/Nr.235/2020 me të cilin ka shfuqizuar vendimin e datës 14.02.2020 duke e obliguar Divizionin e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi, mirëpo Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës në po të njëjtën datë më 29.10.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot: DPSKPK/Nr.236/2020 me të cilin ankuesin e ka pezulluar me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e datës 29.10.2020 me Nr.Prot:DPSKPK/Nr.236/2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 10.11.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 03.12.2020 nxjerrë Vendimin KA.Nr.07/2020 me të cilin ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se ankesa është drejtuar kundër vendimit të udhëheqësit kryesor administrativ të punëdhënësit dhe i cili nuk i mundëson të drejtën e ankesës në këtë rast.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin KA.Nr.07/2020 të datës 03.12.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datën 28.12.2020 parashtron ankesë me numër protokollit 3316/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.01.2021 ka përcjell kërkesën për përgjigje lidhur në ankesën e ankuesit tek organi i punësimit. Sekretariti i Këshillit Prokurorial i Kosovës me datë 14.01.2021 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me provat e kërkuara.

**Administrimi i provave**-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.437/2020, të datës 28.12.2020, me numër protokollit 3316/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi KA.Nr.07/2020 i datës 03.12.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit prokurorial të Kosovës; Ankesa e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datën 10.11.2020 me numër protokollit 1134; Autorizim i datës 19.02.2020; Vendimi i datës 29.10.2020 me numër protokollit DPSKPK/Nr.25/2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për pezullim nga puna; Vendimi i datës 14.02.2020 me numër protokollit DPSKPK/56/2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për pezullim nga puna; Aktvendimi PP/I, nr,21/20 Pejë i datës 07.09.2020 i Prokurorisë Themelore në Pejë –Departamenti i Krimeve të Rënda; Vendimi i datës 29.10.2020 për shfuqizimin e Vendimit të datës 14.02.2020 me numër protokollit DPSKPK/56/2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për pezullim nga puna; Libri i pranimit Vendimi i datës 23.10.2020 i Komisionit Disiplinor KD:Nr.04/2020 me numër protokollit 1043/2020; Kërkesë për kthim në vendin e punës e datës 11.09.,2020 nga përfaqësuesi i autorizuar avokat Vendimi i datës 21.05.2020 me numër protokollit 309/2020 i Inspektoriatit të Punës; Vendim i datës 20.11.2019 i Inspektoriatit të Punës me Nr.01/37-228/19-A; Vendimi KD:Nr.05-A/2019 i datës 04.09.2019 i Komisionit Disiplinor të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Akt emërimi i datës 03/07/2019 për Ankesë e parashtruar përmes



përfaqësuesit të autorizuar avokatit ..... për shkak të heshtjes administrative e parashtruar me datën 21.04.2020 me nr.protokolli 764/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi KA.nr.02/2020 i datës 15.06.2020 me numër protokolli 565 /2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Ankesë e datës 10.03.2020 me numër protokolli 10.03.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Aktvendimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda dhe Aktvendimi PNI.nr.205/2020, më datë 20.02.2020 i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për krime të Rënda; Autorizim i datës 04.03.2029 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit me datën 14.01.2021 me numër protokolli 136/2021 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 18 paragrafit 1.6 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim sepse.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 29.10.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot: DPSKPK/Nr.236/2020 me të cilin ankuesin e ka pezulluar me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Ankuesi përmes përfaqësuesit ligjor avokatit Kujtim Kërveshi me datën 05.11.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës e cila është protokoluuar me datën 10.11.2020 me nr.1134, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me vendimin e datës 03.12.2020 me numër protokolli 1258/2020 ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se ankesa është drejtuar kundër Vendimit të cilin e ka marrë udhëheqësi kryesor administrativ i punëdhënësit dhe i cili nuk i mundëson të drejten e ankesës në këtë rast.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës vendimin e datës 03.12.2020 me numër protokolli 1258/2020 e ka nxjerrë në kundërshtim me nenin 131 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar mbi këtë bazë ligjore dhe nenit 18 paragrafit 1.6 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, obligon Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që të marrë në rishqyrtim ankesën e ankuesit të datës 10.11.2020 me nr.1134 dhe të vendosë në mënyrë meritore për rastin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të provave që posedon në lëndë ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial ka nxjerr vendimin KD.Nr.04/2020 me numër protokolli 1043/2020 të datës 23.10.2020, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largimi nga zyra dhe transferimi në pozitën Receptonist në po të njëjtën Prokurori dhe ndalimi i gradimit për tri(3)vite", ndërsa nga shkresat e lëndës nuk kemi vërejtur se ndaj këtij vendimi është ushtruar ndonjë ankesë dhe se nuk kemi asnjë



M

informacion as nga ankuesi dhe punëdhënësi se cili është efekti juridik i këtij vendimi në këtë procesë, dhe kjo është një arsye ma shumë që ankesa të vendoset nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës duke sqaruar edhe vendimin e potencuar më lartë.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.437/2020, datë 16.02.2021**

**Sabile AVDYLI**  
*Sabile Avdyli*  
**Procesmbajtëse**



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së